



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly Rahovec

Komiteti për arsim

PROCESVERBAL

Mbledhja e komitetit për arsim e mbajtur me datë **21.11.2022 (E hane)** me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e tretë e kryesoi kryesuesja **Fahrije Lushi Morina**.

Kryesuesja - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar sekretar. Besoj që të gjithë me kohë jeni njoftuar, është mbledhja e tretë e komitetit për arsim për këtë vit, si rend dite kemi;

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Niveli i shkollimit të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptianë;
3. Bullizmi dhe dukuritë tjera negative në shkolla;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja – Të nderuar, e vendosim në votim këtë rend dite, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja – A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Niveli i shkollimit të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptianë;

Xhevdet Morina – Përshëndetje. Nxënësit minoritarë të integrohen në sistemin arsimor të Kosovës. Gjatë viteve 1990 sistemi i arsimit në Kosovë ishte në kaos, sidomos me nxënësit e minoriteteve etnike. Shkollimin e gjuhës amtare nxënësit mund ta vijonin vetëm në mënyrë joformale dhe privatisht. Fëmijët e minoriteteve në masë të madhe nuk shkonin fare në shkollë. Pas luftës të vitit 1999, ka patur një rritje të vazhdueshme në pjesëmarrje dhe në cilësi në arsim duke përfshirë edhe minoritetet. Sipas disa statistikave të nxjerrura nga interneti, në vitin 2008 rreth 90% e nxënësve nga minoriteteve kanë vazhduar shkollimin sipas hulumtimit të organizatave të ndryshme. Nga pjesa prej nga vij unë, Dejnë – Dobidol janë integruar minirotetet, në shkollën që punoj unë janë 6 nxënës dhe janë të barabartë me të gjithë nxënësit tjerë. Në Çifllak ka prej atyre që e kanë kryer mësimin universitar dhe sot punojnë si mësues, nga kjo kuptohet që minoritetet te ne janë të integruar plotësisht.

Alban Bajraktari – Përshëndetje kryesuese, kolegë. Sa i përket nivelit të shkollimit të minoriteteve, ne që jemi të kyçur në arsim i njohim pak më mirë etapat e zhvillimit. Sa i përket ligjeve, vendimeve, rregulloreve dhe kushteve, minoritetet i kanë të plotësuar të gjitha. Ekzistojnë vendime të niveleve komunale që i favorizojnë minoritetet për zhvillim, aftësim, arsimim dhe edukim. Gjatë përvojës 19 vite, e kam vërejtur që ata hezitojnë duke u vetë-diferencuar sa i përket kyçjes në sistemin arsimor.

E shoh në rregulloren e fundit që nuk ceket përdorimi i mjeteve teknologjike brenda klasës, duke e ditur që teknologjia dhe digjitalizimi ka evoluuar shumë. Plotësimi është shumë i nevojshëm.


Kryesuesja – Atëherë këtë propozim të Albanit e vendosim në votim. Kush është për plotësim – ndryshimin e rregullores për arsimin e ulët në Rahovec?... Unanimisht kalon edhe ky propozim. Për sot e mbyllim mbledhje, faleminderit.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 10:35

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi

Kryesuesja e mbledhjes;


Fahrije Lushi Morina

